

KONTRATË SHITJE E KUOTAVE TË KAPITALIT

Sot me datë 18.10.2022, u nënshkrua kjo Kontratë ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITESI

1) Nebojsa Trajkovic, shtetas serb, lindur më 10.07.1971, në Beograd, Kralja Bodina 010, mbajtës i pasaportës me nr. 013426393 dhe Nr. Personal:1007971710177;

Dhe

BLERËSI

2) "EDG Service" sh.p.k, shoqëri e themeluar në bazë të ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M02409024E dhe me seli në: Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i saj Z. Lorens Hoxha, në përputhje me Vendimin e Ortakut të Vetëm të datës 18.10.2022;

Në bazë të vullnetit të tyre të lirë, palët ranë dakord për përmbajtjen e kontratës ndërmjet tyre, si më poshtë:

Preambula:

Duke qenë se Shitësi është zotërues i 100 % të kapitalit të kuotave të "GTK OIL" sh.p.k, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NIPT L88527801L, me adresë në Rrugën Nacionale Fier- Ballsh, Vendburimi i Naftës Visokë, Njesia Administrative Qendër, kilometri 10, Sektori i parë, Godina nr. 1 Visokë.

Duke qenë se Shitësi dëshiron të shesë 50% të kapitalit të kuotave që zotëron në "GTK OIL" Sh.p.k, dhe Blerësi merr përsipër të blejë kuotat, në përputhje me Vendimin e Ortakut të Vetëm të datës 18.10.2022;

Duke qenë të vetedijshem për rëndësinë e veprimeve të tyre, si dhe në përmbushje të parashikimeve të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Statutit të Shoqërisë, palët e mësipërme vendosin të lidhin këtë kontratë në përputhje me kushtet si më poshtë.

Neni 1

Qëllimi i Kontratës

1.1 Qëllimi i kësaj Kontrate është transferimi i pronësisë të 50% të kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "GTK OIL" Sh.p.k që zotëron Nebojsa Trajkovic tek "EDG Service" Sh.p.k.

1.2. Kjo Kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrave të transferimit të kësaj pronësie.

Neni 2 Objekti i Kontratës

2.1. Objekti i kësaj kontrate konsiston në shitjen e Kuotave të Kapitalit të "GTK OIL" Sh.p.k, kundrejt pagesës së përcaktuar këtu.

2.2. Me këtë Kontratë, Shitësi është i detyruar t'i transferojë Blerësit 50% të Kuotave të Kapitalit të "GTK OIL" Sh.p.k. Kalimi i pronësisë do të bëhet pasi kjo kontratë të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.3. Blerësi merr përsipër t'i paguajë Shitësit një shumë prej 5.000 (pesë mijë) Euro kundrejt pronësisë së 50% të Kuotave të Kapitalit Kryesor të "GTK OIL" Sh.p.k, ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët.

2.4. Palët bien dakord që kjo kontratë të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe transferimi i kuotave të jetë efektiv, pavarësisht nga dita e pagesës.

Neni 3 Efektet e Kontratës

3.1. Kjo kontratë ka forcën e ligjit për palët kontraktuese.

3.2. Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve të tjera sipas parashikimeve të ligjit.

Neni 4 Zgjidhja e Kontratës

4.1. Në rastet kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta të parashikuara nga kjo Kontratë, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

4.2. Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në rast se pagesa nuk do të kryhet në afatin dhe në shumën e parashikuar më sipër. Në këtë rast kontrata zgjidhet kur pala e interesuar i deklaron palës tjetër se do të përdorë kushtin e zgjidhjes së kontratës.

Neni 5 Kalimi i përgjegjësisë

5.1. Shitësi merr përsipër të dëmshpërblejë Blerësin për çdo humbje të shkaktuar ose të vendosur Blerësit ose Kompanisë si rezultat i rritjes së detyrimeve ose uljes së aktiveve të Kompanisë në lidhje me ato të treguara në pasqyrat financiare në datën e transferimit, me kusht që shkak i drejtpërdrejtë për humbje të tilla ka ndodhur para transferimit.

Neni 6 Interpretimi i Kontratës

6.1. Në rast se do të lind e nevojshme të interpretohet kjo Kontratë, atëherë do të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës.

6.2. Kushtet e Kontratës do të interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit të Kontratës.

6.3. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga Palët.

Neni 7 Baza Ligjore

7.1. Kontrata hartohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

8.1. Blerësi dhe Shitësi angazhohen të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

8.2. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit ndërmjet tyre, problemet do të mundohen të vlerësohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

8.3. Në rast të konflikteve gjyqësore, Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9 Dispozita të fundit



9.1 Kjo marrëveshje është përpiluar në 3 (tre) kopje dhe pas nënshkrimit të saj nga palët secila prej tyre merr nga një kopje, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri.

PALET:

Shitësi:

Z.Nebojsa Trajkovic

NEBOJSA TRAJKOVIC



Blerësi:

“EDG Service” Sh.p.k

Përfaqësuar nga Administratori

Z.Lorens Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L88527801L	
2. Data e Regjistrimit	27/11/2018	
3. Emri i Subjektit	GTK OIL	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	13/11/2018	
6. Kohëzgjatja	Nga: 13/11/2018	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Fier Ballsh BALLSH Rruga Nacionale Fier- Ballsh, Vendlurimi i Naftes Visoke, Njesia Administrative Qender, kilometri 10, Sektori i pare, Godina nr. 1 Visoke.	
8. Kapitali	10.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Veprimtari shërbimesh në lidhje me kërkimin dhe shfrytëzimin e naftes dhe gazit. Kryerjen e cdo aktiviteti tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.	
10. Administratori/ët	NEBOJSA TRAJKOVIC	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 13/11/2018	Deri: 14/06/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	NEBOJSATRAJKOVIC	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 10.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier Fier FIER Mjeti me targa AA 884 XE Fier Fier FIER Mjeti me targa AA 136 XL Fier Fier FIER Mjeti me targa AA 620 VU
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: GTK OIL E-Mail: 13NEBOJSA13@GMAIL.COM Telefon: 0038163391 Të Tjera: Kapitali i shoqerise eshte 10.000 (dhjete mije) Euro
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 18/10/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/10/18 11:07:39 +02:00
L88527801L2022101811071468
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M02409024E
2. Data e Regjistrimit	09/12/2020
3. Emri i Subjektit	EDG SERVICE
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	04/12/2020
6. Kohëzgjatja	Nga: 04/12/2020
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Elbasanit, Vila nr. 71
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Kryerjen e operacioneve perfs hire por pa u kufizuar ne fushen e hidrokarbureve, gazit natyror dhe prodhimit te energjise nga burimet e rinovueshme ne Shqiperi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Kerkim, prodhim, perpunim, transportim shitje, shkembim, eksport te lendeve hidrokarbure naftes dhe nenprodukteve te saj e gazit natyror te lengshem dhe produkteve te ngjashme, etj. Studim-projektim te puseve te kerkimit, vleresimit dhe prodhimit te hidrokarbureve, te rafinerive dhe impianteve te perpunimit te naftes dhe nenprodukteve te saj. Ndertimi dhe montimi i te gjitha mjeteve dhe pajisjeve te kerkuara ne operacionet hidrokarbure dhe te gazit natyror. Tregtia e naftes dhe e nenprodukteve te saj, tregtia e gazit natyror perfs hire dhe pa u limituar ne shitjen, blerjen dhe shkembimin e naftes dhe nenprodukteve te saj si dhe gazit natyror e cila mund te zhvillohet ne territorin e shqiperise ose jashte tij ne perputhje me nevojat e shoqerise. Çdo aktivitet tjeter te dobishem ose te nevojshem per arritjen e objektit te saj ose qe ka lidhje me te ne kuptimin me te gjere te fjales. Studimin, projektimin, vleresimin, konsulencen,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p>sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin me fonde publike ose jo publike (private) ne njesi te ndryshme te prodhimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme perfshire por pa u limituar ne hidrocentrale, parqe cloicke, panele diellore, impianteve per prodhimin e energjise elektrike etj, ndjekjen perkatese te punimeve si dhe mirembajtjen e njesive gjeneruese, ndertimin e linjave te transmetimit te energjise elektrike per tregtim te saj. Tregtia brenda dhe jashte vendit e energjise elektrike, furnizim, shitje, blerje dhe shkembim te energjise elektrike ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Per te realizuar objektin e veprimtrise se saj, shoqeria mund te veproje brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise dhe te kryeje cdo aktivitet tjetër te nevojshem te lidhur, instrumental, te dobishem, te perafert, elementar etj ne funksion te veprimtrise se saj. Ofrim sherbimesh per perdorimin e lendeve eksplozive ne puset e naftes dhe gazit. Kryerjen e matjeve gjeologo - gjeofizike ne puse. Çimentime te puseve. Gërmime, shpime për ekstraktim gurësh, rërash dhe dherave, nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, rërës dhe shistit butiminoz. Veprimtari në fushën e industrisë së naftës, gazit dhe ujit si dhe në atë minerare që lidhen me: studime, projektme, kërkime, zbulime e konturime, nxjerrje dhe zhvillime, shërbime e supervizime. Eksporte, importe dhe prodhimin e makinerive e paisjeve, transportin, grumbullimin, përgatitjen dhe tregtimin. Transport mbetjesh që kanë produkte naftë. Transport ujë teknologjik me naftë nga separatorët ujë/naftë. Transport naftë dhe mbetje të tjera nga shpimet për naftë hidrokarbure të tilla si argjile dhe shllam. Negocime, supervizime, shërbime e ekspertizë në fushën e kontratave hidrokarbure dhe minerare".</p>	
10. Administratori/ët	Lorens Hoxha	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 22/08/2022	Deri: 22/08/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	ENERGY DEVELOPMENT GROUP	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.4 Komete (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier Portez PORTEZ Fier-Patos, Km. 5, Zona Kadastrale 3031, Pasuria me Nr.39/7,Njesia Administrative Portez, Bashkia Fier.
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: EDG SERVICE E-Mail: info@edg.al Telefon: 0686061210
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 18/10/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/10/18 11:05:44 +02:00
M02409024E2022101811052075
2006

VENDIM
I
ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
“EDG SERVICE” SHPK

Sot, më datë 18.10.2022 (dy mijë e njëzet e dy), në selinë kryesore të shoqërisë “EDG SERVICE” shpk, me adresë në Rrugën e Elbasanit, Vila Nr. 71, Tiranë, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 09.12.2020, me NIPT- M02409024E, në cilësinë e Ortakes së Vetme të shoqërisë “EDG SERVICE” shpk, zotëruese e 100 % të kuotave në kapitalin themeltar të saj, mori pjesë në mbledhje shoqëria “Energy Development Group” sh.a., person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 24.09.2008, me NIPT- K82124007R, e përfaqësuar nga administratori i saj Z. Sokol Meqemeja, shtetas shqiptar, lindur më 28.06.1969, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me Nr. Personal: G90628152K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1- Blerjen nga Z. Nebojsa Trajkovic, shtetas serb, lindur më 10.07.1971, në Beograd, Kralja Bodina 010, mbajtës i pasaportës me nr. 013426393 dhe Nr. Personal:1007971710177, të 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit që ai zotëron në Shoqërinë “GTK OIL” Shpk, identifikuar me NIPT- L88527801L, për vlerën nominale prej 5.000 (pesë mijë) Euro;
- 2- Autorizimin e Administratorit të shoqërisë Z. Lorens Hoxha të nënshkruajë Kontratën përkatëse të Shitblerjes së 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit të përshkruar në këtë Vendim.

VENDOSI:

- 1- Blerjen nga Z. Nebojsa Trajkovic shtetas serb, lindur më 10.07.1971, në Beograd, Kralja Bodina 010, mbajtës i pasaportës me nr. 013426393 dhe Nr. Personal:1007971710177, të 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit që ai zotëron në Shoqërinë Shoqërinë “GTK OIL” Shpk, person juridik shqiptar, regjistruar



pranë QKB-s më datë 27.11.2018, identifikuar me NIPT- L88527801L, në vlerën nominale prej 5.000 (pesë mijë) Euro;

- 2- Autorizimin e Administratorit Z. Lorens Hoxha të nënshkruajë Kontratën përkatëse të Shitblerjes së 50% të pjesës së kapitalit të përshkruar në këtë Vendim dhe të çdo dokumentacioni apo akti ligjor të nevojshëm në kuadër të kësaj procedure.
- 3- Të miratojë depozitimin e këtij *Vendimi* pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe çdo institucioni tjetër ku është e nevojshme, *Kontratën e Shitblerjes së kuotave të Kapitalit* që do të lidhet midis palëve dhe dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e transferimit të kuotave.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË “EDG SERVICE” SH.P.K
SHOQËRIA “ENERGY DEVELOPMENT GROUP” SH.A
PËRFAQËSUAR NGA ADMINISTRATORI I SAJ
Z. SOKOL MEQEMEJA





Tiranë, më 18.10.2022

**VENDIM
I AKSIONARIT TË VETËM TË SHOQËRISË
“ENERGY DEVELOPMENT GROUP” SH.A.**

Sot, më datë 18.10.2022 (dymijë e njëzet e dy) në selinë e shoqërisë “Energy Development Group”sh.a., të ndodhur në adresën: Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Tiranë, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, më datë 24.09.2008, me NIPT- K82124007R, unë, Aksionari i Vetëm i Shoqërisë “Energy Development Group”sh.a, Sokol Meqemeja, shtetas shqiptar, lindur më 28.06.1969, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me Nr. Personal: G90628152K, e cila është Ortake e Vetme e shoqërisë “EDG SERVICE” shpk person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 09.12.2020, me NIPT- M02409024E, pasi shqyrtova çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

1. Diskutimi dhe miratimi i blerjes nga ana e shoqërisë “EDG SERVICE” shpk, me NIPT- M02409024E të 1 (një) kuote që Z. Nebojsa Trajkovic, shtetas serb, lindur më 10.07.1971, në Beograd, Kralja Bodina 010, mbajtës i pasaportës me nr. 013426393 dhe Nr. Personal:1007971710177, që zotëron në Shoqërinë “GTK OIL” Shpk, identifikuar me NIPT- L88527801L, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit, në vlerën nominale prej 5000 (pesë mijë) Euro;

VENDOSI:

1. Blerjen nga ana e shoqërisë “EDG SERVICE” shpk, me NIPT- M02409024E, të 1 (një) kuote që Z. Nebojsa Trajkovic, shtetas serb, lindur më 10.07.1971, në Beograd, Kralja Bodina 010, mbajtës i pasaportës me nr. 013426393 dhe Nr. Personal:1007971710177, që zotëron në Shoqërinë “GTK OIL” Shpk, identifikuar me NIPT- L88527801L, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit, në vlerën nominale prej 5000 (pesë mijë) Euro;
- 2- Të miratojë depozitimin e këtij *Vendimi* pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe cdo institucioni tjetër ku është e nevojshme, *Kontratën e Shitblerjes së kuotave të Kapitalit* që do të lidhet midis palëve dhe dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e transferimit të kuotave.

**AKSIONARI I VETËM I SHOQËRISË
“ENERGY DEVELOPMENT GROUP” SHA**

SOKOL MEQEMEJA

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20221018142920241
Data e Rezultatit te Kerkimit: 18.10.2022
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 2:29:20PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-687-1091
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

GTK OIL SH.P.K.



Oleg Hidri